# DËSHMI ARKIVI

**A-454463**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Situatë alarmante me koncesionet”/ Grupi Parlamentar i PD-së propozon paketë ligjore që të gjurmojë fondet publike |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/situate-alarmante-me-koncesionet-grupi-parlamentar-i-pd-se-propozon-pak-i104797` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 09:24:11 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 09:10:52 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2809d0066085e4e7738a4e184794ed7fbc2a317226d620b1c340d035100bd2b5` |
| TEKSTI | `74acf4423825c0acb69774aaf7cc6486724489c16d14bf5ef0fac4e1a3a42902` |
| PAMJA | `dc9836a9a0c2b7fe930e5ca031edc29bea122516dec630298cbb840ad2d0a17c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8186a9f9830fb805b130ecdfc3b3b1ec2782fb676aae8d5eec9e08e717e1b027` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `219f872b2d436154cbce21b1357d2a6f04cc2d43ba2a7914d91c1ebdf0665477` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8186a9f9830fb805b130ecdfc3b3b1ec2782fb676aae8d5eec9e08e717e1b027`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# “Situatë alarmante me koncesionet”/ Grupi Parlamentar i PD-së propozon paketë ligjore që të gjurmojë fondet publike

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 11:10




Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka ndërmarrë një hap zyrtar në Kuvend duke depozituar një paketë të re ligjore, e cila synon të vendosë nën kontroll dhe monitorim të rreptë çdo fond publik apo pasuri që përdoret nga subjekte private.

Përfaqësuesit e opozitës, Enno Bozdo dhe Ivi Kaso, e kanë cilësuar situatën aktuale në vend si alarmante, duke theksuar se gjatë pesë viteve të fundit qeveria e drejtuar nga Edi Rama ka shënuar rekorde negative për sa i përket korrupsionit dhe grabitjes së fondeve e pasurive publike.

Sipas opozitës, kjo mazhorancë ka miratuar një numër të madh ligjesh speciale dhe ka ngritur agjenci e kompani shtetërore apo guackë, të cilat financohen drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit pa u dhënë llogari qytetarëve. Si raste konkrete u përmendën ligjet speciale të tipit Fusha, Korporata e Investimeve Strategjike që menaxhon pronat me vlerë publike, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për shërbimet e teknologjisë së informacionit, ndërmarrjet e reja për menaxhimin e pyjeve dhe sektorin bankar, si dhe KAYO, e cila parashikon kontrollin e blerjet në sektorin e shëndetësisë me qindra milionë euro çdo vit.

Përfaqësuesit e PD-së argumentuan se kuadri aktual ligjor nuk garanton transparencë dhe nuk lejon as kërkimin e informacionit, jo më auditimin e këtyre fondeve që kalojnë në duart e privatëve. Përballë kësaj situate, nisma e re ligjore e propozuar nga Partia Demokratike synon të amendojë tre ligje kyçe: atë për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Me këtë paketë, opozita synon të sjellë një model të ngjashëm me vendet e zhvilluara evropiane, duke garantuar në mënyrë përfundimtare gjurmimin, kontrollin dhe vlerësimin e çdo fondi publik që shfrytëzohet nga subjekti privat.

*Sot jemi përpara jush, për të prezantuar nismën ligjore të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, nisëm e cila do të mundësojë në mënyrë përfundimtare dhe pa asnjë ekuivok, gjurmimin, kontrollin, vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve apo masave për përdorimin e cdo fondi publik apo pasurie publike, në cilëndo formë dhe në cilëndo mënyrë që ato përdoren apo shfrytëzohen nga Privati.*

*Me pak fjalë, sot ne sapo kemi depozituar zyrtarisht në Kuvend, një inisiativë ligjore që amendon tre ligje:*

*Në 5 vitet e fundit, qeveria e Edi Ramës ka shënuar rekorde negative të padëgjuara përsa i përket korrupsionit, grabitjes së fondeve publike dhe pasurive publike. Kjo mazhorancë ka miratuar*

*pafund ligje speciale, ka ngritur agjenci që menaxhojnë pasuritë më të mira publike të shqiptarëve, kompani guackë që financohen vec nga buxheti i shtetit, të gjitha këto në forma juridike me qëllim te vetëm cimentimin e një mburoje ligjore të padepërtueshme, pas të cilave fshihen, në emër të kontratatve dhe shoqërive tregtare private, miq të ngushtë të kryeministrit dhe kontributorë të partisë në pushtet.*

*Rastet janë pafund: duke filluar që nga ligjet speciale sic ishte Ligji Fusha, tek ngritja e Korporatës së Investimeve Strategjike e cila menaxhon cdo pronë me vlerë publike, të kompania e AKSHI-t, që do të menaxhojë pa garë dhe pa asnjë llogaridhënie të paktën 200 milonë euro në vit shërbime për TI, të kompania KAYO që nëpërmjet 5 bijave të veta do të marrë cdo vit qindra milionë euro por pa iu nënshtruar asnjë auditimi apo kontrolli publik, e deri tek inisiativa e fundit për KAYO-Bis, ndërmarrjen shtetërore që do të kontrollojë të gjitha blerjet në sektorin e shëndetësisë. E sigurisht këtu mund të përmendim, kompanitë shtetërore të sapokrijuara për menaxhimin e pyjeve, në sektorin bankar, pra, në të gjtha sektorët e ekonomisë ku transferohen qindra milionë euro para publike dhe ku nuk mund sot, as të kërkosh informacion sepse askush nuk përgjigjet, e jo më të kërkosh llogari apo të auditosh se ku realisht shkojnë këto para, si përdoren dhe cili i përfiton.*

*Përballë kësaj situate të paprecedentë të grabitjes së organizuar të parasë dhe pronës publike, ne vijmë sot më nismën ligjore përkatëse, e cila i jep një përgjigje të drejtpërdrejtë këtyre shqetësimeve, duke propozuar një model që vende të rëndësishme evropiane, shumë herë më të zhvilluara se ne, e kanë adoptuar më kohë.*

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 18 Shtator10:52

**“Provo dil, të tërheqin zvarrë”/ Tabaku i kujton Ramës 110 ditë protesta: Mos trego arrogancë, por jep dorëheqjen**

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, iu drejtua kryeministrit Edi Rama gjatë replikës së saj në Kuvend ditën e djeshm...

POLITIKE 18 Shtator10:47

**‘Rama si monark, baronët mbledhin taksat’, Hasimja: ‘Kayo’ në Shëndetësi, monopolizim e feudalizëm**

Për analistin dhe politologun Ermal Hasimja, ardhja e Klodiana Spahiut në krye të Ministrisë së Shëndetësisë, ësh...

POLITIKE 18 Shtator10:37

**Bardhi “shpërthen” në akuza ndaj Ramës: Ka projektuar një shtet privat. Po hakmerret ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, s’e i kanë trokitur te dera për Belindën!**

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka replikuar ashpër në Kuvend me kryeministrin Edi Rama për lig...

POLITIKE 18 Shtator10:29

**‘Djali i Pankartës’, Ani Marku tregon detaje nga shoqërimi: Pankarta simbol kombëtar, ofenduese si e hodhën**

I njohur tashmë nga qytetarët si ‘Djali i Pankartës’, Ani Marku ka dhënë detaje nga shoqërimi i tij në komisari...

POLITIKE 18 Shtator09:58

**‘Performanca’ e Klodiana Spahiut në Kuvend/ Alimehmeti: Humbje qetësie! A është modeli ‘Kayo’ mision?!**

Drejtuesi i Departamentit të Shëndetësisë në PD, Ilir Alimehmeti ngre dyshime të forta mbi emërimin e Klodiana Spahiut n&eu...

POLITIKE 18 Shtator09:19

**12 orë debat/ Nga KAYO te miratimi i draftit për pagat e magjistratëve, çfarë ndodhi në seancën maratonë në Kuvend**

Kuvendi u mblodh në seancë plenare ditën e djeshme, (17 shtator 2026), në një seancë maratonë që zgjati më shum&e...

POLITIKE 18 Shtator08:59

**‘Policia u sul ndaj protestuesve si bishë e egërsuar’, Tepelena: U jemi kthyer në makth!**

Për aktivistin Andi Tepelena, ajo se çfarë po ndodh me policinë në raport me protestuesit ëskhtë e papranueshme, ndë...

POLITIKE 18 Shtator08:44

**111 protesta kundër qeverisë, sot qytetarët do të mblidhen sërish në shesh përpara Kryeministrisë: Rama jep dorëheqjen!**

Protestuesit do të zbresin sërish sot në shesh, ndërsa shënohet dita e 111-të e revoltës së tyre kundër kryeminis...

POLITIKE 18 Shtator07:51

**Përplasja me magjistratët, Rama paralajmëron ligj të ri për piramidën e pagave**

Kryeministri Edi Rama, në fjalën e tij pas mesnate në Parlament përpara se të miratohej projektligji i Partisë Socialiste pë...

POLITIKE 18 Shtator07:41

**Parlamenti voton me 84 vota pro projektligjin e PS për pagat e magjistratëve, PD kundër**

Parlamenti miratoi pas mesnate me 84 vota pro, 24 kundër dhe 1 abstenim projektligjin e PS-së për pagat e magjistratëve, që parashiko...

**ME TE VIZITUARAT**

AKTUALITET 17 Shtator

**[Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jet...]**

Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

POLITIKE 17 Shtator

**[Tensionet te ministria e Brendshme, shoqërohet ...]**

Vijojnë tensionet para Ministrisë së Brendshme. Një grup protestuesit kanë hedhur letra higjienike në drejtim të policis&e...

BOTA 17 Shtator

**[I veshur si grua, 33-vjeçari 'tradhtohet' dhe a...]**

Ai pothuajse ia kishte dalë, por një tatuazh e tradhtoi. Jordan Lopes da Silva, 33 vjeç, ishte maskuar si grua, duke vendosur një paruke, ...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

**[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues]**

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...

## video



### E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV



**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**



**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.